



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇËSHTJEVE DHE SHËRBIMEVE JURIDIKE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE JIURIDIKE

Nr. 1524 prot.

Tiranë, më 30.05.2022

URDHËR

Nr. 49 , datë 30.05.2022

“PËR
MIRATIMIN E PROGRAMIT PËR INFORMIMIN DHE KOMUNIKIMIN
PUBLIK TË ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË”

Në mbështetje të nenit 147/d, të Kushtetutës, dhe në zbatim të nenit 204, të pikës 1, të germës “c”, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Programit për Informimin dhe Komunikimin Publik të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Ngarkohen inspektorët dhe administrata e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me zbatimin e këtij urdhri.
3. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse për njoftimin dhe publikimin e këtij urdhri, në faqen zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Artur Metani





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇËSHTJEVE DHE SHËRBIMEVE JURIDIKE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE
SEKTORI I NDIHMËS JURDIKE DHE ANKESAVE**

**PROGRAMI
PËR
INFORMIMIN DHE KOMUNIKIMIN PUBLIK
2022-2023**

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bazuar në nenin 194 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, është autoriteti përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë.

Transparenca dhe mirinformimi janë në qendër të komunikimit publik të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për të zbatuar vizionin e shpallur prej ngritjes së institucionit, se në fokus të ILD-së është gjetja e balancës midis interesit publik për administrimin e drejtësisë dhe respektimit të pavarësisë së magjistratëve, pasi sa më i pavarur të jetë magjistrati, aq më i garantuar është qytetari për të drejtat e tij.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka analizuar të dhënat statistikore me synimin parësor paraqitjen e informacionit sasior dhe cilësor të përmbledhur që karakterizon dukuri të caktuara. Konkretisht, parë nga numri i lartë i ankesave që vijnë nga kategoria individ, janë identifikuar të dhëna që i përkasin subjektit dhe objektit të ankesave. Analizimi i këtyre të dhënave është parë me dobi në funksion të hartimit të politikave të brendshme të punës, jo vetëm për të përmirësuar shërbimin në funksion të interesit publik dhe transparencës, por edhe kuptimit më të mirë të individit që paraqet ankesë dhe zhvillimin e politikave ndërjegjësuere në këtë drejtim.

Ankesat më të shumta i referohen shkeljeve me objekt vendimmarrje të padrejta të magjistratëve gjatë shqyrtimit të një çështje, shkelje procedurale dhe zvarritje të procesit gjyqësor/hetimor. Sa i përket ndarjes së kategorisë midis magjistratëve, rezulton se ankuesit ankohen më tepër për subjekte të procedimit disiplinor, të profilit gjyqtar. Ndërsa për kategorinë veprime apo

mosveprime në kundërshtim me ligjin, analiza e të dhënave ka nxjerrë në pah se magjistratët e profilit prokuror, ata që kanë numrin më të lartë të rasteve.

Për ankesat e paraqitura nga individë, janë grumbulluar edhe dy tregues, gjinia dhe grup-mosha e ankuesve. Konkretisht nga të dhënat e grumbulluara, rezulton se nga ankesat e shqyrtuara, 626 ankues i përkasin kategorisë “meshkuj” dhe 226 ankues i përkasin kategorisë “femra”. Ndërsa sa i takon grup-moshës, ankesat më të shumta të paraqitura nga individë, i përkasin grup-moshës mbi 60 vjeç.

Nxjerrja në pah e këtyre të dhënave është parë si tregues që lidhet ngushtësisht me kuptimin e misionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nga publiku i gjerë. Kjo lidhet me një ndër përparësitë që ka Inspektori i Lartë, në drejtim të rritjes së ndërgjegjësimit të publikut mbi misionin e veprimtarisë së ILD-së. Të dhënat e përfutuara i shërbejnë hartimit të politikave në këtë fushë me synim thjeshtimin dhe kuptimin e drejtë të misionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Rritja e ndërgjegjësimit të publikut, është premisë për krijimin e lehtësirave në minimizimin e fluksit të ankesave, të cilat janë jashtë objektit të veprimtarisë, apo janë të papranueshme për shkak të mos përbushjes së kriterëve ligjore. Evidentimi i të dhënave i shërben nevojave për përmirësim, qoftë në nivel dhënie shërbimi, por edhe të kuptimit nëse ndërgjegjësimi ka arritur të përbushë qëllimin e tij, atë të thjeshtimit dhe edukimit të publikut në drejtim të kuptimit të drejtë të sjelljeve që i japin shkak procedimit disiplinor nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Duke mbajtur në konsideratë analizimin shterues të të dhënave, referuar edhe tërësisë së mjeteve të komunikimit si: botimet, aktivitetet, lajmet, mediat sociale, grupet e interesit, shtresat e margjinalizuara, etj., vlerësohet hartimi dhe miratimi i një plani të detajuar ndërveprimi, ILD-publik, përmes të cilit do të mundësohet rritja e besimit të publikut. Përmirësimi i vazhdueshëm i transparencës në sytë e publikut, në lidhje me mënyrën se si operon dhe ushtron kompetencat Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, do jetë objektiv kryesor i këtij plani ndërveprimi.

Gjatë vendosjes së objektivave në këtë dokument, janë mbajtur në konsideratë, rritja e transparencës dhe konsolidimi i besimit të publikut në veprimtarinë e ILD-së.

Programi për Informimin dhe Komunikimin Publik për vitet 2022-2023, përmbledh detyrimet funksionale që rrjedhin nga Rregullorja e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nga Plani Strategjik dhe Plani i Veprimit për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 2020-2022 dhe dokumente të tjera të miratuara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Gjithashtu, ky program mbi të gjitha reflekton rekomandimet e lëna për zbatim nga Rezoluta e Kuvendit “Për vlerësimin e punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2020 (shkurt-dhjetor)”, ku konkretisht në pikën 8 të saj rekomandohet “*Promovimi dhe rritja e ndërveprimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me qytetarët ndërmjet aktiviteteve, informimeve periodike, pasurimit informativ të faqes duke përdorur çdo kanal tjetër të komunikimit publik*”.

Ky program është një dokument pune, i cili shërben si udhërrëfyes në realizimin e objektivave institucionale dhe të sektorit përmes përcaktimit të masave dhe aktiviteteve konkrete.

Rritja e ndërveprimit me publikun veç përditshmërisë së punës, do të mundësojë përhapjen e informacionit në mënyrë të mjaftueshme, si përmes informacionit të publikuar, takimeve me qytetarët dhe të gjitha organizmat që ndërlidhen me veprimtarinë e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë. Me përmbushjen e planit pritet të arrihet synimi, që Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të mos mbetet si një institucion me detyrimin ligjor për të dhënë informacion me kërkesë të ankuesit, mbi fazën në të cilët ndodhet ankesa apo kërkesa të tjera, por të luajë rol proaktiv në funksion të transparencës dhe besueshmërisë.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, përmes një procesi kompleks duke përfshirë shqyrtimin e reagimeve të drejtpërdrejta nga publiku (takim të drejtpërdrejtë me ankuesin) dhe nga grupet e interesit, sikurse nëpërmjet monitorimit të mediave, kryerjes së sondazheve rreth perceptimit publik dhe analizimit të të dhënave/statistikave, synon:

- ✚ Ndërgjegjësimin e vazhdueshëm të publikut për vizionin, misionin, qëllimet strategjike dhe objektin e veprimtarisë së ILD-së;
- ✚ Thellimin e bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe mediat në funksion të veprimtarisë së ILD-së;
- ✚ Rritjen e koordinimit dhe efikasitetit të komunikimit të brendshëm të institucionit.

Elementë të dobishëm

- ✚ Faqja e internetit është mjete kryesor i komunikimit me publikun dhe si i tillë do vijojë të ofrojë informacion të përditësuar, si në drejtim të legjislacionit e akteve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ashtu edhe në lidhje me veprimtarinë e ILD-së, numrin e ankesave të ardhura dhe në proces trajtimi dhe të përfunduara, vendimet për propozimin e fillimit të hetimit disiplinor, vendet vakante, të dhënat e stafit, etj.;
- ✚ Informimi publik dhe i medias do vijojë të kryhet përmes burimeve zyrtare të institucionit, faqes së internetit, adresave e-mail, llogarive në rrjetet sociale dhe buletinit periodik. Ky lloj komunikimi do intensifikohet në rastet me interes të veçantë për publikun; kur ka vendimmarrje të rëndësishme; kur ka ndonjë aktivitet në të cilin media/publiku mund të marrë pjesë etj.
- ✚ Kthimi i përgjigjeve aktorëve të interesuar, qytetarë, media apo institucione, duke balancuar kohën e shpejtë me profesionalizmin në ofrimin e informacionit në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme;
- ✚ Ofrimi i shpjegimeve (pa cenuar procedurën etapat e shqyrtimit dhe verifikimit të ankesave) për publikun dhe median për të kuptuar procedurat dhe etapat që ndjek ankesa nga depozitimi deri në vendimmarrjen e ILD-së.

E drejta e publikut për qasje në informacionet zyrtare

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, do ruajë praktikën e mirë të krijuar tashmë në informimin publik, me vëmendje të posaçme në afatet e përcaktuara nga ligji nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, për dhënien e informacionit publik.

Informacioni publik që përditësohet në vijimësi në Programin e Transparencës, pasqyron në mënyrë shteruese (në rubrika, tekste/përmbajtje, afate të përcaktuara kohore për bërjen publike të informacionit, mënyrën e bërjes publike, si dhe strukturën përkatëse, e cila prodhon ose administron dokumentin) veprimtarinë e ILD-së, nëpërmjet publikimit të detajuar në faqen zyrtare www.ild.al, si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet qartë vendndodhja e informacionit zyrtar në hartën e faqes së internetit dhe përditësimin, si në formë dhe përmbajtje.

Programi për informimin dhe komunikimin publik për vitet 2022-2023, parashikon **objektiva të strukturuar** si vijon:

1. Ofrimi i asistencës për ankuesit;
2. Promovimi i veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
3. Garantimi i të drejtës së informimit;
4. Garantimi i transparencës;
5. Monitorimi i qasjes së publikut ndaj veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

OBJEKTIVI I: OFRIMI I ASISTENCËS PËR ANKUESIT

| Nr.1 | Masat / proceset e planifikuara | Aktivitetet dhe detyrat konkrete | Struktura Përgjegjëse | Afate / komente |
|------|--|--|---|--------------------|
| 1.1 | Ofrimi i asistencës/këshillimit juridik për të gjithë personat që paraqiten pranë zyrës ILD për të paraqitur ankesë. | Ofrimi i asistencës/këshillimit për të gjithë personat që paraqiten pranë zyrës ILD për të paraqitur ankesë përmes: <ul style="list-style-type: none"> - Organizimit të takimeve me ankesit; - Njohjes me problematikën e ankesit; - Informimit të ankesit mbi kompetencat dhe fushën e veprimtarisë së ILD; - Asistimit në plotësimin e formularit TIP të ankesës; - Informimit mbi mënyrat e plotësimit dhe depozitimit të ankesës në ILD; - Informimit në lidhje me rrugën që ndjek ankesa prej depozitimit në Zyrën e Arkiv-Protokollit deri në vendimmarrjen përfundimtare. | Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Juridike, Sektori i Ndihmës Juridike dhe Ankesave | Proces në vijimësi |

| | | | | |
|-----|---|---|--|--------------------|
| 1.2 | <p>Ofrimi i asistencës/këshillimit për të gjithë personat nëpërmjet komunikimit me telefon në numrin zyrtar.</p> | <p>Ofrimi i asistencës/këshillimit për të gjithë personat nëpërmjet komunikimit me telefon në numrin zyrtar përmes;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njohjes me problematikën e ankesit; - Informimit të ankesit mbi kompetencat dhe fushën e veprimtarisë së ILD; - Orientimit të ankesit mbi informacionin që gjendet në faqen zyrtare të internetit www.ild.al, në rubrikën '<i>Si pranohen ankesat</i>' në të cilën gjendet formulari TIP dhe Udhëzuesi përkatës; - Informimit mbi mënyrat e plotësimit dhe depozitimit të ankesës në ILD; - Informimit në lidhje me rrugën që ndjek ankesa prej depozitimit në Zyrën e Arkiv-Protokollit deri në vendimmarrjen përfundimtare; - Caktimit të takimit në Zyrën e ILD, në përputhje me kërkesat e publikut. | <p>Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Juridike, Sektori i Ndihmës Juridike dhe Ankesave</p> | Proces në vijimësi |
|-----|---|---|--|--------------------|

| | | | | |
|--|--|--|--|--------------------|
| 1.3 | Përmbledhja dhe Raportimi i çdo asistence të ofruar ankesit. | Përmbledhja dhe Raportimi i çdo asistence të ofruar ankesit përmes: <ul style="list-style-type: none"> - Evidencat të detajuara të problematikës së parashtruar nga ankesit, në takimet e realizuara pranë ambienteve të institucionit, si dhe nëpërmjet komunikimit në telefon, duke i pasqyruar ato në grafikun e punës on-line në përdorim të Drejtorisë së Shërbimeve Juridike; - Përcjelljes së informacionit mbi problematikat e ngritura nga ankesit nëpërmjet raportimit javor në rend hierarkik të shpërndarë përmes postës elektronike. - Analizimin i të dhënave me qëllim hartimin e planeve/urdrave apo dokumenteve të tjerë orientues, me synim adresimin e çdo problematike të dalë si rezultat i përpunimit të informacionit. | Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Juridike në bashkëpunim me Kabinetin | Proces në vijimësi |
| OBJEKTIVI 2: PROMOVIMI I ZYRËS SË INSPJEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË | | | | |
| Nr.2 | Masat / proceset e planifikuara | Aktivitetet dhe detyrat konkrete | Struktura Përgjegjëse | Afate / komente |
| 2.1 | Prodhimi i materialeve informative | Prodhimi i materialeve informative print dhe vizuale përmes: <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitjes së broshurave dhe fletëpalosjeve edukative /informative apo audiovizuale me gjuhë lehtësisht të kuptueshme; | Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Juridike në bashkëpunim me Kabinetin | Viti 2022 |

| | | | | |
|------------|---|--|---|-----------------------------|
| | | <ul style="list-style-type: none"> - Përzgjedhja e materialit pjesë përbërëse të saj; - Printimit të broshurave dhe vendosja e tyre në këndin informativ, në pjesë të dukshme dhe të aksesueshme të institucionit, si dhe shpërndarja e tyre gjatë aktiviteteve të ndryshme që do të zhvillohen; - Publikimi i broshurave/materialeve audiovizuale në faqen zyrtare të internetit dhe llogaritë në rrjetet sociale të ILD-së. | | |
| 2.2 | Konceptimi dhe realizimi i Këndit Informativ | <p>Në Këndin Informativ të evidentohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Broshurat informative; - Formulari TIP i ankesës; - Udhëzuesi i miratuar për plotësimin e Formularit të Ankesës; - Harta e Ankesës e printuar në format të dukshëm; - Buletini Mujor. | <p>Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Juridike</p> | <p>Viti 2022 e në vijim</p> |
| 2.3 | Zhvillimi i një turi informues në gjykatat/prokuroritë më të mëdha të vendit | <p>Zhvillimi i një turi informues në gjykatat/prokuroritë më të mëdha të vendit përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Organizimit të 12 aktiviteteve informuese rreth kompetencave të ILD-së në çdo qark, në gjykata dhe zyra të prokurorive, pranë Zyrave të Marrëdhënies me Publikun përkatëse;¹ | <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Njësia e Inspektorëve, Kabineti, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e</p> | <p>Viti 2022-2023</p> |

¹ Në qytetet qendër qarku, etj.,

| | | | | |
|------------|--|--|---|----------------|
| | | - Orientimit të nëpunëve të gjykatave/prokurorive, si dhe nxitjen për të përfshirë një rubrikë në faqen e tyre të internetit për të ankimuar pretendimet për shkelje disiplinore të magistratëve. ² | Shërbimeve Juridike, Ndhimës/inspektor | |
| 2.4 | Organizimi i takimeve me studentët e Fakultetit të Drejtësisë | Organizimi i 4 takimeve me studentët e Fakultetit të Drejtësisë, në 4 universitetet të cilat kanë në përbërje programe studimi të së drejtës, si dhe numrin më të lartë të studentëve. ³ | Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Njësia e Inspektorëve, Kabineti, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Juridike, Ndhimës/inspektor | Viti 2022-2023 |
| 2.5 | Takime informuese me grupet e interesit | Organizimi i 3 deri në 5 takimeve formale me media/OJF me fushë veprimtarie transparente dhe aksesin e publikut në drejtësi. | Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Njësia e Inspektorëve, Kabineti, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Juridike, Ndhimës/inspektor | Viti 2022-2023 |
| 2.6 | Fushata sesibilizuese me aktorë të pushtetit vendor në rang qarku | Organizimi i 4 takimeve me aktorë të pushtetit vendor si: nëpunës të zyrave të marrëdhënieve me publikun pranë njësive vendore, etj. ⁴ | Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Njësia e Inspektorëve, Kabineti, Sekretari i Përgjithshëm, | Viti 2022-2023 |

² Do ndryshohet në përputhje me hartën e re gjyqësore.

³ Universiteti i Tiranës, Universiteti i Vlorës, Universiteti i Shkodrës dhe një nga universitetet jo-publike.

⁴ Në Bashkitë me popullsi më të madhe sipas statistikave zyrtare.

| | | | | |
|--|--|---|---|------------------------|
| | | | Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Juridike, Ndhimës/inspektor | |
| 2.7 | Hartimi i një politike për takime në ditë të hapura | Organizimi i takimeve të hapura në ditë të caktuara, (Dita e Drejtësisë, përvjetori i ngritjes së ILD-së, etj.,) për informimin e publikut mbi rolin dhe veprimtarinë e ILD-së. | Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Njësia e Inspektorëve, Kabineti, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Juridike, Ndhimës/inspektor | Viti 2022-2023 |
| OBJEKTIVI 3: GARANTIMI I TË DREJTËS SË INFORMIMIT | | | | |
| Nr.3 | Masat / proceset e planifikuara | Aktivitetet dhe detyrat konkrete | Struktura Përgjegjëse | Afate / komente |
| 3.1 | Përbushja e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga ligji nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” brenda afateve të përcaktuara. | Për përbushjen e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga ligji nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” brenda afateve të përcaktuara, me qëllim bashkërendimin e punës për garantimin e së drejtës së informimit, Inspektorit i Lartë i Drejtësisë përmes koordinatorit për të drejtën e informimit: - Mundëson të drejtën e çdo kërkuesi për t’u njohur me informacionin publik duke u konsultuar me dokumentin origjinal ose duke marrë një kopje të tij; | Koordinatori për të Drejtën e Informimit/ Sekretari i Përgjithshëm | Proces në vijim |

| | | | | |
|--|--|--|------------------------------|------------------------|
| | | <ul style="list-style-type: none"> - Krijon, mban, publikon dhe përditëson regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të nenit 8 të ligjit; - Bashkërendon punën për kthimin e përgjigjeve të kërkesave për informacion, brenda afateve dhe sipas mënyrës së parashikuar në ligj; - Regjistron kërkesat për informacion dhe cakton një numër rendor për secilën prej tyre; - Dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezultoni se ILD nuk e zotëron informacionin e kërkuar; - Verifikon rastet për dhënien falas të informacionit qytetarëve, sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 13, të ligjit; - Kryen njoftimet paraprake, sipas neneve 14 dhe 15, të ligjit, si dhe komunikon me kërkuesin, sipas nevojës për trajtimin e kërkesës për informacion publik. | | |
| OBJEKTIVI 4: GARANTIMI I TRANSPARENÇËS SË ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË | | | | |
| Nr.4 | Masat / proceset e planifikuara | Aktivitetet dhe detyrat konkrete | Struktura Përgjegjëse | Afate / komente |

| | | | | |
|-----|---|---|--|-------------------------|
| 4.1 | <p>Pasqyrimi në faqen zyrtare të internetit të çdo njoftimi/lajmi/aktiviteti në versionin shqip dhe anglisht</p> | <p>Pasqyrimi në faqen zyrtare të internetit të çdo njoftimi/lajmi/aktiviteti në versionin shqip dhe anglisht përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitjes së njoftimit për shtyp në pasqyrim të aktivitetit përkatës - Zbardhjen e intervistave në media/forumeve të ndryshme të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe përgatitjes së tyre për publikim; - Ndarjes përmes postës elektronike grupit të gazetarëve të çdo njoftimi/lajmi/aktiviteti nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; - Ilustrimit me foto/video të rastit për çdo aktivitet të pasqyruar. | <p>Sektori i Ndihmës Juridike dhe Ankesave në bashkëpunim me Këshilltarin për Median</p> | <p>Proces në vijim</p> |
| 4.2 | <p>Punimi i Buletinit Mujor</p> | <p>Buletini Mujor:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Publikohet çdo fillim muaji në faqen zyrtare të internetit www.ild.al dhe në llogarinë e ILD në rrjetet sociale. - Realizohet në formatin dygjuhësh (shqip dhe anglisht). - Ndahet përmes postës elektronike, listës së gazetarëve të akredituar, gjithë stafit të Zyrës së ILD-së, punonjësve të Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun në Gjykata dhe Zyra të Prokurorive të vendit, organizatave të shoqërisë civile, etj. | <p>Sektori i Ndihmës Juridike dhe Ankesave në bashkëpunim me Këshilltarin për Median</p> | <p>Çdo fillim muaji</p> |

| | | | | |
|---|---|--|---|---|
| 4.3 | Përditësimi i Kanalit Zyrtar Twitter | Pasqyrimi në Twitter i aktiviteve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në sistemin dygjuhësh (shqip dhe anglisht) dhe i të dhënave statistikore javore të procesit të ankimit dhe i veprimtarisë apo deklaratave të ILD-së. | Sektori i Ndhimës Juridike dhe Ankesave në bashkëpunim me Këshilltarin për Median | Proces në vijim |
| 4.4 | Përditësimi i Kanalit Zyrtar Youtube | Pasqyrimi i intervistave/fjalimeve audiovizive të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në kanal zyrtar të ILD në Youtube. Me qëllim informimin, edukimin dhe përshpejtimin shpërndarjes së materialeve audiovizive. | Sektori i Ndhimës Juridike dhe Ankesave në bashkëpunim me Këshilltarin për Median | Proces në vijim |
| 4.5 | Përmbledhje Statistika | Përditësimi i rubrikave të statistikave (me bazë javore dhe mujore) mbi veprimtarinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në lidhje me: <ul style="list-style-type: none">- Numrin e Ankesave të trajtuara;- Numrin e Ankesave të konfirmuara;- Numrin e Ankesave në proces trajtimi;- Numrin e Ankesave në proces verifikimi pas shqyrtimit fillestar;- Numrin e Vendime për fillim Hetimi Disiplinor;- Numrin e Kërkesave për procedim disiplinor. | Drejtoria e Shërbimeve Juridike në bashkëpunim me Zyrën e Arkiv-Protokollit dhe Këshilltarin për Median | Çdo të hënë Çdo fillim muaji (të dhënat për Buletinin) |
| OBJEKTIVI 5: MONITORIMI I QASJES SË PUBLIKUT | | | | |

| Nr.5 | Masat / proceset e planifikuara | Aktivitetet dhe detyrat konkrete | Struktura Përgjegjëse | Afate / komente |
|------|--|---|---|-----------------|
| 5.1 | Hartimi i pasqyrës ditore të shtypit dhe ndarja për përdorim të brendshëm nëpërmjet postës elektronike | <ul style="list-style-type: none"> - Monitorimi i mediave me qëllim për mirësimin dhe ofrimin e informacionit, kur ka pasaktësi/mungesë informacioni; - Evidentimi i botimeve për sistemin e drejtësisë dhe veprimtarisë së ILD-së në veçanti, me qëllim thithjen e opinionëve mbi performancën e institucionit. | Sektori i Ndihmës Juridike dhe Ankesave | Proces në vijim |
| 5.2 | Hartim i pyetësorit “Për Opinionin e Ankuesit” | <p>Në kuadër të rritjes së besimit të publikut, si dhe për përmirësimin e punës në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është hartuar ‘Anketa mbi veprimtarinë e ILD-së’ në mënyrë që çdo qytetar të ndajë përvojën personale mbi shërbimin e ofruar.</p> <p><u>Qëllimi i anketimit është:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Orientimi i veprimtarisë së ILD-së, në pajtim me nevojat e publikut; - Forcimi i besimit të publikut tek veprimtaria e ILD-së; - Sensibilizimi i publikut mbi të drejtat dhe detyrimet gjatë proceseve gjyqësore. | Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Juridike, Sektori i Ndihmës Juridike dhe Ankesave | Proces në vijim |

| | | | | |
|-----|---|--|--|-----------------|
| 5.3 | <p>Ndjekja e zhvillimeve të ditës dhe denoncimeve publike në lidhje me sistemin e drejtësisë dhe raportimi i tyre tek Këshilltari për Median</p> | <ul style="list-style-type: none"> - Ndjekja e mediave nëse informacionet që përfitohen mund të shërbejnë si indicie për të filluar një hetim kryesisht, nëse përmbushen kriteret e parashikuara në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, - Ndjekja e denoncimeve publike për veprimtarinë e magjistratëve, me qëllim informimin e institucionit mbi dinamikat dhe problematikat e paraqitura. | <p>Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Njësia e Inspektorëve, Kabineti, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Juridike, Ndhimës/inspektor</p> | Proces në vijim |
|-----|---|--|--|-----------------|